

## HIMARIOTËT NË REGJIMENTIN MAQEDONO - ILIR TË MBRETËRISË SË NAPOLIT 1734 – 1861 (1)

Lutfi ALIA

Arbereshi Papàs Andrea Filia, më 12 qershor 1764, në relacionin dërguar Rev. Papàs Paolo Parrino, rektori i Seminarit Albanezo – Grek të Palermos, krahas informacioneve për gjendjen e albanezëve të përqëndruar në Kapitanata të Pulias, tregon dhe për mobilizimin e albanezëve në rradhët e Regjimentit Maqedon të Mbretërisë së Napolit. Doreshkrimi i murgut Filia, i ruajtur në arkivin e Famullisë Shën Nikolla të Mezzojusos (Cartella n III, Carpetta n° 1 - Fascicolo n° 3), është transkriptuar dhe botuar nga Giuseppina dhe Pietro Di Marco. (1)

Arbëreshi Papàs Paolo Parrino, ishte bashkëpuntori i themeluesit të seminarit P. Giorgio Guzzetta. Parrino kishte shkruar një vepër, që mbeti e pabotuar: “Di perpetua Ecclesiae Albanenses concessione cum Romanem”, e cila ndodhet e arkivuar në seminarin Albanezo – Grek të Siçilisë. Papàs Parrino vdiq me 5 maj 1765. (2)

Papàs Andrea Filia pasi kishte shërbyer prift në famullinë e Chieuti ne Kapitanata (Foxhia) dhe në famullinë Shen Pjetri dhe Pali në Napoli, deri në fund të jetës shërbeu kapelan i Regjimentit Maqedon të Mbretërisë së Napolit. Vitet në këtë regjiment i dhanë mundësinë të njihite mirë oficerat dhe ushtarët albanezë. (3, 4)

Familja e Andrea Filia ishte me origjinë nga Filati i Çamerisë, e ardhur në Itali në gjysmën e parë të shekullit XV. Disa pjestarë të familjes u vendosën në Mezzojuso të Siçilise dhe një pjesë në Pulja. Se bashku me familjen Filia, ne Pulja zbarkuan dhe shumë banorë nga Kuçi, të cilët u shpërndanë nëpër disa vendbanime të Siçilisë. Nga familja Filia dhe Kuçi, kishte shumë oficera në Regjimentin Maqedon të Mbretërisë së Napolit. (1)

Pasi përshkruan gjendjen e albanezëve, të këtyre banorëve të rinj të krishterë, të vendosur në Pulia gjatë viteve 1468 - 1495, Andrea Filia tregon se në vitin 1583, në Otranto zbarkuan disa familje himarjote mes tyre familjet e Gjergj dhe Merkur Sasso, nga fshati Sasaj afër Shën Vasilit në Provincën e Himares. Të dy vellezerit u ndanë, Gjergji u vendos në Chieuti (Kieuti), ndërsa Merkuri në Portokanone. (1)

Në vazhdim të relacionit, Filia tregon se në vitin 1680, zbarkuan në Pulja familja Golemi, nga fshati Golem i Epirit, si dhe familja e arvanitasve Gjergji, të ardhur nga Maina e Moresë, se bashku me dy priftërinj ortodoks Giorgio dhe Makario Sevasto, të cilët u stabilizuan në Chieuti (Kieuti), ku kryenin shërbime te ritit ortodoks.

Më 4 mars 1743, në Pulja zbarkoi një grup i madh familjesh himariote, të cilat me urdhër të mbretit të Napolit, u sistemuan në Villa Badesse, në provincën e Peskarës - Abruco. Në këtë, grup ishin dhe 18 familje me origjinë nga Piqerasi, të cilët pas sulmeve dhe grabitjeve që kishin pësuar nga banorët e Golemit, të Borshit, si dhe nga turqit, ishin detyruar të braktisin vendlindjen, të zbarkonin në Brindizi dhe të vendosen në Faggiano (Faxhiano). Së bashku me piqerasit ishin dhe disa familje nga Lukova.

Nder familjet e vendosura ne Vila Badessa, ne shekullin XVIII u shquan kapitenët Kostantin Blassi e Pati Gjini dhe majori Demetrio De Mikeli, të cilët u inkuadruan në radhët e Regjimentit Maqedon të Napolit. (1)

Komuniteti albanez në Vila Badessa, shërbehej nga priftërinj të ritit ortodoks, si basiliani Makario Nika nga Piqerasi dhe nga priftërinjtë himariotë Demetrio Atanasi, Gjon Nika, Spiridon Andrea, Mikel Spiro Andrea, të cilët si shkruan Andrea Filia “me zell dhe dashuri i shërbyen kësaj gregje të vogël albanezësh”. (1)

Piktoria dhe shkrimtaria anglosaksone Estella Canziani (Kanciani), në vitin 1911 vizitoi Abrucon dhe rezultatet e studimeve etnografike, i botoi në veprën “Permes Apenineve dhe trojeve te Abrucos”, ku ndër të tjera shkruan: “Kishim dëgjuar të flitej për arbëreshët në fushat

e Sulmona. Ata ruanin besime të vjetra të çuditëshme, besonin në *drekësit* (Driadat), në *murgarat* (shtrigat) dhe në *fiatazat* (zanat). Nga këto takime mbresëlënëse, Kanciani realizoi një pikturë në vaj, portertet e dy grave arbëreshe të Vila Badessa. (5)

Në Villa Badessa jeton një komunitet arbëresh, më saktë italo-albanez, një thesar historik dhe kulturor pak i njohur. Në komunën Rosciano (Roshiano) të Peskarës, në vitin 1743 jetonte një komunitet historik, i lidhur me mbretërinë e Borbonëve të Napolit. (5)

Si theksohet në enciklopeditë italiane të vjetra dhe aktuale, arbëreshët e Villa Badesse, për shumë shekuj e ruajtën kulturën etnike, ritin ortodoks, veshjet, doket dhe deri në vitin 1956 e ruajtën dhe gjuhën albaneze. (6)

Për mobilizimin e himariotëve në Regjimentin Maqedon të Mbretërisë së Napolit, kontribuoi Imzot Giuseppe Schirò (Zef Skiroi) nga Piana degli Albanesi, i cili pasi shërbeu 18 vjet misionar në Himarë, në vitin 1736 u konsakrua Ipeshkëvi i Durrësit. Imzot Skirò i kerkoi dy himarioteve Strati Gjika dhe Zotit Pani, të mobilizojnë djemë himarjotë për në Regjimenti Iliro – Maqedon të Napolit. (1, 4)

Konti Strati Gjika, fisnik i pasur i Himarës, në vitin 1734 u thirr nga Mbreti Borbon Karli i Napolit (më pas Karli III – mbreti i Dy Siçilive), i cili e ngarkoi të rekrutonte bashkatdhetarët e tij, për të formuar Regjimentin Iliro – Maqedon të Mbretërisë së Napolit. (3,4, 7, 8, 9)

Në vitin 1735, Mbreteria e Napolit u shfaq në skenën europiane e drejtuar nga Karli, një sovran ambicioz, i cili për ta ngritur shtetin e tij në nivelin e fuqive të tjera, kërkoi të shkëputej nga hegjemonia spanjolle. Karli krijoi një aparat modern adiministrativ, ekonomik dhe sidomos ushtarak, që e forcoi nëpërmjet rekrutimit të mercenareve të huaj, duke krijuar ushtri të fuqishme për t'u perballur me fuqitë e medha europiane. (4, 7, 10)

Në Peruxhia, më 5 mars 1734, Karli Borbon kaloi në revistë ushtinë, e cila perbehej kryesisht me ushtar të huaj si spanjollë, vallonë, zviceranë, gjermanë, albanezë, maqedonë, irlandezë, grekë, malazeze e pak italianë.

Më 24 maj 1734, në betejën e Bitonto, regjimentet e Karlit korrën një fitore të bujshme kundër garnizoneve austriake. Njëkëtë betejë u shqua batalioni i albanezëve i komanduar nga konti Strati Gjika. Pas kësaj disfate, ushtria perandorake u tërhoq nga Pulja. Siçilia e mbetur e pambrojtur, u pushtua lehtë nga ushtria e Montemar. Pasi mori me rradhë të gjitha kështjellat napolitane, më 10 maj 1735, Karli hyri triumfues në Napoli, i pritur me entuziazëm nga populli. (4, 10, 11)

Më 3 korrik 1735, në katedralen e Palermos, Karli III u kurorzua Mbreti i Napolit dhe i dy Siçilive. (4, 9).

Më 10 gusht 1744, ushtria e Karlit III e përbërë kryesisht me regjimente mercenarësh të huaj, në betejën e Velletri, korri një fitore tjetër kundër ushtisë perandorake. Suksesin e kësaj beteje, mbreti Karli III ia dedikoi albanezëve të fanterisë Maqedono – Ilire, i përbërë nga albanezë, malazezë dhe maqedonë. (10, 11)

Themelimi i regjimentit Maqedono - Ilir, ka protagonist kryesor kontin albanez Strati Gjika nga Dhermiu, i cili pasi kishte shërbyer toger në ushtinë e Republikës së Venedikut, për konfliktet me eprorët, e degraduan, madje Serenisima e shpalli person i padëshirueshëm. Në këto rrethana, Strati Gjika u largua nga Venecia dhe shkoi në Napoli. (6, 7, 11)

Mbreti Karli III e ngarkoi Strati Gjiken të mobilizonte himariotët në shërbim të koronës së Napolit. Gjika organizoi dhe drejtoi operacionet e rekrutimit të mercenarëve në territoret e Albanisë, Maqedonisë dhe Greqisë.

Banorët e këtyre vendeve shquheshin si luftëtarë trima, por nuk ishin të disiplinuar për të milituar në reparte tërregullta. (9, 10)

Strati Gjika nuk u kufizua vetëm në territore të pushtuara nga Perandoria Osmane, por shkoi dhe në Dalmaci. Këto aktivitete të Gjikes rane në sy të Venedikut, që e kishte dënuar në mungesë, madje shpalli se paguanin 100 monedha ari për atë që do ta vriste. (11, 13) Ky lajm nxiti ambicjen e piratëve ulqinakë, të cilët sulmuan një anije me rekruta malazeze, duke

menduar se aty ndodhej dhe konti Strati Gjika, por nuk e gjetën dhe mbetën duar bosh, nuk e fituan shpërblimin e majmur të premtuar nga Serenisima. (12, 13)

Cesare Vignola përfaqesues i Venecias në Napoli, e informonte rregullisht Serenisimën për aktivitetin dhe lëvizjet e Strati Gjikes për rekrutimin e albanezëve. Në informacionin e 10 korrikut 1736, Vinjola shkruante se 500 albanezë, pasi kishin zbarkuar në Otranto, ishin nisur për në Napoli, për t'u inkuadruar në Regjimentin

e komanduar nga Strati Gjika. (10, 14)

Në vitin 1737, në "Piazza di Capua", u formua zyrtarisht batalioni "Real Macedonia", i përbërë nga albanezë, me komandant nën-kolonelin Strati Gjika. Me shtimin e rradhëve me mercenarë të tjerë, në vitin 1739 u themelua Regjimenti Maqedon, me dy batalione, i pari me komandant Strati Gjika, në të dytin Giorgio Korafa. Në ceremoninë e organizimit të regjimentit, në prani të mbretit Karl, komandanti i batalionit II, koloneli Korafa, u prezantua me veshje albaneze dhe me shpatën e Gjergj Kastriotit Skenderbeut, shpatën e famëshme "Enesis", që Ai e mori në muzeumi e Kapodimonte të Napolit. Me këtë gjest fisnikërie Korafa krijoi entuziazëm të madh në rradhët e ushtarëve dhe të pjesëmarrësve. (4, 9, 10, 11, 13)

Në përbërje të ushtrisë të Mbretit Karli III Borbon, ishin inkuadruar 11 regjimente me ushtarë të huaj:

**1. Regjimenti "Reali Guardie Svizzere"**, i komanduar nga koloneli zviceran Giuseppe Antonio Tschudy.

**2. Regjimenti "Fonseca"**, i përbërë nga mercenare korsikas, ku militonte oficeri Paskuale Paoli, udhëheqësi i irredentizmit për pavarësi të Korsikës nga Republika e Genova.

Në prill të viti 1755 Korsika fitoi pavarësinë dhe Paskuale Paoli u zgjodh kryetar i Republikës.

**3. Dy regjimente "Macedone" ose "Illirico"**, me mercenarë të ardhur nga Macedonia, Albania, Greqia

dhe Dalmazia (kryesisht nga Mali i Zi). Komandant Regjimentit I u emërua nën-kolonel Strati Gjika, i cili

në vitin 1784 u gradua gjeneral, ndërsa regjimenti II komandohej nga koloneli Giorgio Korafa, të cilin në

vitin 1775 e graduan gjeneral. (9, 10)

**4. Dy Regjimente Svizeriane "Jauch" e "Wirtz"**, që mbanin emrat e dy komandantëve respektiv.

**5. Tre Regjimente "Hainaut", "Anversa" dhe "Namur"**, të formuar me ushtarë vallonezë dhe gjermanë.

**6. Regjimenti "Re"**, i formuar me mercenarë të mobilizuar në Irlandë.

**7. Dy regjimente kavalerie "Rosiglione" dhe "Dragoni Tarragona"**, të formuar me spanjollë..

Pas vdekjes të Karlit III, në fronin e mbretërisë u ngjiti biri Ferdinandi IV, i cili u kurorëzua mbret me 6 tetor 1759, por me që Ai ishte minore, për drejtimin e mbretërisë u krijua një këshillë regjence i drejtuar nga kryeministri Tanuçi, ndërsa Ferdinandi iu besua princit të San Nikadro, i cili u kujdes për edukimin e tij.

Koloneli Giorgio Korafa vdiq në Ischia në vitin 1775 dhe komandën e Regjimentit Maqedon e mori koloneli Strati Gjika. Pas vdekjes së tij, komandant u emërua i biri Anastas Gjika. (4, 9, 10, 13)

Mbreti Ferdinand IV e vazhdoi traditën e të Atit, urdhëroi mobilizimin e ushtarëve në Albania. Këtë mision ia ngarkoi gjeneralit Diego Naselli, i cili për rekrutimin e ushtarëve albanezë, dërgoi në Himarë dy oficerë të besuar Xhiovan Spiro dhe Kristofor Dukagjini, të cilët u lidhën me parinë e fshatrave të Himarës, në veçanti me Kostantin Kasnecin. Të dy emisaret e mbretit, firmosën një marrëveshje të re, për rekrutimin e himarjotëve në ushtrinë e Ferdinandit IV, si dhe garantuan 10 vende studimi në Kolegjin Nunziatella të Napolit, për fëmijët e

parisë të fshatrave të Himarës. Kjo marrëveshje u firmos edhe nga Ali Pashë Tepelena. (4, 9, 10, 13, 14)

Ferdinandi IV, në vitin 1778 e riformoi në mënyrë radikale ushtrinë dhe marinën. Në krye të ushtrisë emëroi gjeneralin irlandez John Akton, të cilin më pas e emëroi Ministër i Luftës. Pothuaj në të gjitha njesitë ushtarake u emëruan oficerë të huaj, mes tyre albanezë, të cilët krijuan një aparat ushtarak të fuqishëm dhe me efikasitet drejtues, që e shndërroi armatën në një instrument luftarak eficient. (9, 10, 11, 13, 15)

Regjimenti me albanezë, i quajtur “Coppoloni” (Coppoloni do të thotë kapuçanët, sepse ushtarët mbanin kapuçin, apo festën karakteristike albaneze), ishte ndër repartet më të shquara në veprimet luftarake, por edhe më i pa disiplinuari, në periudhat kur qëndronte në kazermat e Napolit.

Në vitin 1789, me urdhër të Ministrisë së Luftës, regjimenti i albanezëve u shkri, mercenarët hiamriotë u shpërndanë, disa u rikthyen në vendlindje, shumë të tjerë kaluan në shërbim të fisnikëve italianë. (4)

Ne vitin 1798, Ministria e Luftës u detyrua t'i kërkojë përsëri albanezët, të cilët i organizoi në “Batalionin e pushkatarëve vullnetarë Albanezë”, i cili quhej dhe batalioni i “Camiciotti”- i “Fustanellave”, për veshjen

karakteristike shqiptare me fustanella. (4, 9, 10, 13)

Në reformën e vitit 1800, batalioni i pushkatarëve albanezë u inkuadrua në regjimentin “Real Macedonia”. Deri në vitin 1812, rekrutët i mobilizonin kryesisht në Albania. Ne vitin Ferdinando IV i Napolit dhe i III i

Siçilisë, u quajt Ferdinandi I i Mbretërisë së dy Sicilive. Me dekretin e 17 janarit 1818, u riorganizua regjimenti i të huajve, ku u përfshi dhe batalioni i “Cacciatori Macedoni”, ku ishin dhe kompanitë e albanezëve. Me rënien e Mbretërisë së dy Sicilive, më 14 shkurt 1861, repartet me albanezë kaluan në varësi dhe në shërbim të piemontezëve, që morën fronin. (4, 9, 10, 13, 15)

### **Lista e oficerave nga Provina e Himarës, në Regjimentin Maqedon të Mbretërisë së Napolit.**



Arbëreshi Primaldo Koko (Coco) O. M, në veprën “Casali albanesi nel Tarentino – Studio storico critico, con documenti inediti”, botuar në vitin 1921”, prezanton listën e oficerave himarjotë, që militonin në njesitë e Regjimentit Maqedon të Mbretërisë së Napolit në vitin 1794. (16)

Kjo liste, botohet sipas dokumentave të Arkivit të Shtetit të Napolit. (7, 16)

Me që emrat janë shkruar në italisht, I kam transkriptuar në shqip për të dhënë emrat origjinale.

#### **DOKUMENTI 15**

Inspektori marshall-kavaleri Diego Naselli, regjistroi emrat e oficerave të mobilizuar në Provicën e Himarës në Epir, me gradat e sejcilit dhe me pagën respektive (Archivio di Stato di Napoli. Min. Est. Filza 4253) (7)

<b>Vendi ërblimi (rroga)</b>	<b>Emri</b>	<b>Mbiemri</b>	<b>Grada</b>	<b>Shp</b>
<b>Nivica</b> (Kumi)		Cesare		Cumi
Nicola (Nikolla)	Gicca (Gjika)	kapiten	3 monedha ari	
Lasca (Laska)	Pristi	toger	2	“
Nicola (Nikolla)	Menxi (Menkshi)	kapiten	3	
Dimo (Dhimo)	Damo (Dhamo)		toger	2
Costa (Kosta)	Niclecca (Nikleka)	“	2	
Stefano	Duca (Duka)	“	2	
Dimo (Dhimo)	Colia (Kolia)	“	2	
Costa (Kosta)	Cesare (Çezari)		nen-toger	2

Stilo	Pristi	“	“	1 e ½ monedha ari	
Polio	Murgazzi (Murgasi)		“	“	1 ½
Laser (Lazer)	Gicca (Gjika)		“	“	1 ½
Dimo (Dhimo)	Duca (Duka)		“	“	1 ½
Vrano	Martico (Martiko)	tenente			1 ½
<b>Shen Vasili</b>	Viero	Costa (Kosta)		kapiten	3
monedha ari					
Stefano	Zovanni (Xhovani)	“		3	
Nellio (Nelo)	Bocci (Boçi)	toger		2	
Martico (Martiko)	Lasca (Laska)		nen-toger	1 ½	
Nestora (Nestor)	Cherchessi (Kerkesi)	“	“	1 ½	
Dimo (Dhimo)	Gini (Gjini)		“	“	1 monedhë ari
Spiro	Pristi	“	“	1 ½ monedha ari	
Lusca (Lushka)	Nova		“	“	1 ½
Stilo	Costa (Kosta)		“	“	1 ½
Attanasio (Athanas)	Pristi		“	“	1 ½
Lasca (Laska)	Pristi		“	“	1 ½
<b>Udezzovo</b>	Cesare (Çezar)	Martiri			“ “ 2
monedha ari					
<b>Lukova</b>	Spiro	Costa (Kosta)	Martiri	kapiten	3
Costa (Kosta)		Martiri		toger	2
Cesare (Çezar)		Martiri		toger	1 ½
Polimero	Spiro		nen-toger	1	
Cesari (Çezar)		Cussari (Kusari)		toger	3
<b>Picherni</b>					
<b>Piqeras</b>	Costa (Kosta)	Kemdro		kapiten	3
monedha ari					
Michele (Mikel)	De Micheli (Mikeli)	“		3	
Nicola (Nikolla)	Zacco (Zaho)	toger		1 ½	
<b>Cleparò</b>					
<b>Qeparò</b>	Demetrio	Niclecca (Nikleka)		kapiten	3
Cesare (Çezar)	Spiro		toger	1 ½	
Cumi (Kumi)	Michele (Mikele)		“	1 ½	
Gioia (Xhoia)	Gini (Gjini)		nen-toger	1	
Martino (Martin)	Duca (Duka)	kapiten		2	
Malio	Pali		nen – toger	1	
Spiro	Cocea (Kocea)		“	“	1
Cicea (Çiço)	Dinagiocca (Dinogjoka)		“	1	
<b>Drimades</b>					
<b>Dhermi</b>	Zaccaria (Zakaria)	Gicca Uretto (Gjika)		kapiten	3
monedha ari		Nicola (Nikolla)	Pristi Uretto	toger	2
Diacò (Dhjako)	Dima (Dhima)			toger	2
Demetrio (Dhimiter)	Polimero		nen – toger	1	
Nestoro	Gicca Nina (Gjika)	kapiten		3	
Dimo (Dhimo)	Gionilia (Gjonilia)		“	3	
Pano	Dima Calojero		toger	2	
(Dhima Kallogjeri)					
Polimero	Lecca (Leka)		“	2	
Pano	Elia Bicilli (Biçilli)		“	1 ½	
Pario	Elia Versi		nen – toger	1 ½	

Dimo (Dhimo)	Vasso Bicilli	“	“	1	
Nicola (Nikolla)	Pristi Cocca (Koka)	“	“	1 ½	
Nestora	Dimdedi (Dhimodedi)	“	“	1	
Giocca (Gjoka)	Tigiocca (Tigjoka)	“	“	1	
Dimo (Dhimo)	Bua	“	“	1	
Coea (Koçea)	Atanasio Lecca (Leka)		tenente		2
Spiro (Polimer Gjoka)	Polimergioca		nen – toger	1	
Nicola (Nikolla)	Gicca Bielli (Gjika)	toger		1 ½	
Giocca (Gjoka)	Zaene (Zane)		nen – toger	1	
<b>Palasa</b> ari	Zacco (Zaho)	Zorzi	“	“	3 monedha
Per pjestaret qe jane nga familje jo te denja per t'u permendur edhe pse jane numeroze vlen te shperblehen se paku me 7 monedha ari					
<b>Vuno</b> monedha ari	Atanasio (Athanas)	Zurra		kapiten	3
Polimero	Spiro	toger		2	
Cristoforo (Kristofor)	Dima (Dhima)		“		2
Costa (Kosta)	Atanassi (Arhanasi)		“		2
Nicola (Nikolla)	Michele (Mikeli)	“		2	
Spiridion	Dima (Dhima)		“	2	
Atanasio (Athanas)	Gini (Gjini)		kapiten		2
Atanasio (Athanas)	Nestora		nen – toger	1 ½	
Nicola (Nikolla)	Andrea		kapiten		3
Gicca (Gjika)	Spiro	toger		2	
Cristoforo (Kristofor)	Nestora		kapiten		2
Atanasio (Athanas)	Giolecca (Gjoleka)		nen – toger	1	
Spiro	Andoni	“	“	1	
Elia	Laguri		“	“	1
Lecca (Lek)	Chireo (Qirjo)		“	“	1 ½
Nestora (Gjok-Athanas)	Giocatanasi	“	“	1	
Savo	Gorazzi (Goraci)	“	“	1 ½	
Costa (Kosta)	Sciacco (Shaka)	toger		1 ½	
Gicca (Gjika)	Coegicca (Kogjika)	“		1 ½	
Dimo (Dhimo)	Dedagicca (Dedgjika)		nen - toger	1 ½	
Lavo	Andoni		“	“	1
Dimo (Dhimo)	Santo	nuk u pagua, pasi u la ne dispozicion te S. M.			
<b>Liatos</b> monedha ari	Elia	Cocca (Koka)		kapiten	3
<b>Himara</b>	Costa (Kosta)	Dimi Pristi		“	3
Gicca (Gjika)	Coevesci (Koroveschi)		toger		2
Zaccaria (Zakaria)	Menleo	“		2	
Dimo (Dhimo)	Stratti Govazzi (Govaci)	“		2	
Elia	Dimalexi (Dhimoaleksi)	kapiten		3	
Gicca (Gjika)	Burbo	toger		2	
Alexi (Aleks)	Pristi	toger		2	Ianni
(Jani) Spiro	Morcola (Morkola)	“		1	
Elia Cristofor	Morcola (Morkola)		“	1	
Polimero Andrea	Varsi		kapiten	1	

Nestore Zaccaria	Varsi	“	2		
Nicola Zaccaria	Varsi	“	2		
Nicola (Nikolla)	Polimero	“	6		
Spiro Costa (Kosta)	Polimero	toger	1		Dimo
(Dhimo)	Vasili Polimero	“		1	
Dimo	(Dhimo)				Pani
Ghionussi	(Gjinushi) kapiten	2			Dimo
(Dhimo)	Ilzaena	toger		1	
Ioanni (Jovan)	Stragini (Stragjini)	“		2	
Spiridione	Bocci Gini (Boçi Gjini)	“		2	
Pietro	Gicconi (Gjikoni)	nen – toger		1 monedhë ari	
Nicola (Nikolla)	Columba (Kolumba)	toger		2 monedha ari	
Gieca	Cocaleschi (Kokaleshi)	“		1	
Spiridion	Spiro	“		2	
Nicola (Nikolla)	Costa (Kosta)	nen – toger		1	
Stelio					Miciocesare
(Miçoçezari)	toger	2		Teodoro	Reggio
(Rexho)	kapiten	2			
Ioanni (Jovan)	Petrogini (Petrogjini)		nen – toger	1	
Spiro	Attanasi Muzzo (Muxo)	“	“	2	
Stratti	Michele (Mikel)	toger		1 ½	
Spiro	Cesargica (Çezar Gjika)	“		1	
Zaccaria (Zakaria)	Zaenagiocca (Zeno Gjoka)	“		1 ½	
Michele Nicolò	Pristi	“		1 ½	
(Mikele Nikolò)					
Stratti	Gioca (Gjoka)			“	1
½	Vasilli	Condalexì (Konda Aleksì)	“		1
½					
Gicca Spiro (Gjika)	Dimostamo (Dhimostamo)	“		1 ½	
Stratti	Mantho		“		1 ½
<b>Licursi</b>					
<b>Likursi</b>	Muceo (Muço)				Dima
(Dhima)	kapiten	3 monedha ari			
Costa (Kosta)	Tausi (Taushi)	“		3	
Gioca (Gjok)	Cesare (Çezari)	“		3	
Gicca (Gjika)	Lazzari (Lazari)	toger		2	
Stefano	Lasca (Laska)	nen – toger		1 ½	
Lazaro (Llazar)	Nestora	“		“	1
Licca (Lika)	Capo (Kapo)	“	“	1	
Lasca (Laska)	Marticoduli (Martiko Duli)	“	“	1	
Costa (Kosta)	Niepristi (Nieprishti)	“	“	1	
Spiro	Giccapettani (Gjika Petani)	toger		2	
Dimo (Dhimo)	Anastasi	nen – toger		1	
Martino	Capuci (Kapuçi)	“	“	1	
Costantino (Kostantin)	Prifti	“	“	1	
Lista e prindërve të kadetave, që njëkohesisht duhet të përfshihen në numërin e regjistruar për gradimet dhe shpërblimet:					
Stefano	Dulli	kapiten		4 monedha ari	
Lago (Lako)	Dassi (Dashì)	toger		2	
Prifti	Urano	kapiten		3	

Spiro	Bodini	toger	2
Gicca (Gjika)	Spiro Lasca (Laska)	kapiten	3
Elia	Spiro	toger	3
Nestore	Casnezi (Kasneçi)	“	3
Crisanto (Krisanthi)	Casnezi (Kasneçi)	kapiten	5
Cumi (Kumi)	Nina	“	3
Zaccaria	Casnezi (Kasneçi)	“	3
Zaccaria (Zakaria)	Andruzzi (Andruci)	toger	2
Pjestarët e parisë të cilëve duhet t'iu jipen shperblime, pensione jetese, shpenzime udhëtimi per t'iu pergjigjur kerkesave te S. M (Sua Maesta – Madherise se Tij), jane emrat ne vazhdim:			
<b>Lukova</b>	Stefano	Cesare (Çezari)	1 monedha ari
Gicca (Gjika)	Nestora		1
Ploimero	Niccolò (Nikolla)	1	
<b>Piqeras</b>	Spiro	Ioanni (Jovani)	1
Michael (Mikel)	Lazze (Laze)	1	
Costa (Kosta)	Pixio (Piksio)		1
Nicco (Niko)	Martini	1	
<b>Qeparò</b>	Gicca (Gjika)	Zuppa (Zhupa)	1
Attanasi	Luimei	1	
<b>Dhermi</b>	Nestora	Neccio (Neçi)	1
Spiro	Attanasi (Athanasi)	1	
Nestora	Ioanni (Jovani)	1	
Pano	Spirodedi	1	
Dimitri	Grogini (Grogjini)	1	
Giovanni (Xhiovan)	Nicca (Nika)	1	
Cristoforo (Kristofor)	Nina	1	
<b>Vuno</b>	Spiro	Cesare ()	1
Cesare	Duca (Duka)	1	
Pano	Pristi	1	
Duca	Pristi	1	
Gicca (Gjika)	Ghioni (Gjoni)	1	
Elia	Guma	1	
Elia	Casa (Kaza)	1	
Dimo (Dhimo)	Strutti		1
Gicca (Gjik)	Savococca (Savokoka)	1	
Gicca (Gjik)	Scetto (Sheti)	1	
Dimo (Dhimo)	Dedea (Deda)		1
Dimo (Dhimo)	Cesare Chiossi (Kiosi)		1
Cicea (Çiço)	Colecca (Koleka)	1	
Dimo (Dhimo)	Ghiondedea (Gjondeda)		1
<b>Cadossi, Dosco</b>			
<b>Piluri</b>	Gicca (Gjika)	Martiri	3
monedha ari			
Gicca (Gjika)	Cippa (Çipa)		1
Nicco (Niko)	Giocamartirir (Gjok Martiri)	1	
<b>Himara</b>	Gicca (Gjika)	Andrea	1 monedhë ari
Gicca (Gjika)	Iodori	1	
Stratti	Carami (Karami)	1	
Nestora	Varfilia (Varfi Ilia)	1	
Dimo Dimichil	Stragini (Stragjini)	1	



Dimo Andrea	Iorgo (Jorgo)		1
Dimo (Dhimo)	Andrealexì (Andrea Aleksi)		1
Iorgo (Jorgo)	Petragini (Petragjini)		1
Nestora	Mexi (Meksi)		1
Spiro Elia	Nestora		1
Nestora	Dimil Zaena	1	
Marco Nicolò (Mark)	Menico (Meniko)		1
Dimo Nestora	Casnezi (Kasnezi)	1	
Vasilli	Micheli (Mikeli)		1

Në vazhdim janë emrat e oficerave nga Kuçi dhe Dukati, të cilet duhet të shpërblehen, t'u jepen pensione jetese dhe shpenzime për udhëtimet sipas vendeve të poshtëshenuara dhe pse të perzier mysliman dhe të krishterë, të gjithë janë dakort dakort t'i dedikohen S. M (Madherise se Tij):

### **Kuçi**

Spiro	Kuro	kapiten		3 monedha ari
Conto (Konto)	Mitro	toger		2
Serael	Dima (Dhima)	“		1
Metto	Dima (Dhima)	“		1
Pano	Spiro	“	1 ½	
Gicca	Cota (Kota)	“	1	
Nano	Martiduca	“	1	
(Martin Duka)				
Zoto	Pietri	“	1	
Giaffer (Xhaferr)	Costa (Kosta)	kapiten		3
Nano	Martiri	toger		1 ½
Izzo (Ico)	Muceio (Muçaj)	“	1 ½	
Gono	Ito (Hito)	“	1 ½	
Amet	Costa (Kosta)	“		1
Spiro	Dodo	“	1 ½	
Ali	Attanasi	nen – toger	1	
Zenel	Matto	“	“	1
Giulio (Xhulio)	Costa (Kosta)	“	“	“
Dede	Conti (Konti)	“	“	1

Shpërblehet me 3 monedha ari edhe priftit Zakaria Kontatino si pjestar i parisë dhe i shkolluar i fshatit Kuçi.

### **Klasa e parë**

#### **Ducates**

<b>Dukati</b>	Ali	Sendali	kapiten	3
Assan (Hasan)	Isso	nen – toger	2	
Malio (Malo)	Podaco (Podako)	“	“	2
Cesare (Çezar)	Ghioni (Gjoni)		toger	2
Asco (Hasko)	Celio (Çelo)	“		2
Momo	Sinani		“	2
Manlio	Attanasi	“	“	2
Memisa (Memish)	Muntersani	“		2

### **Klasa e dytë**

Zappa (Zhapa)	Lerideli		1 ½	
Zebro	Zeno		1 ½	
Gicca (Gjika)	Daico (Dajko)			1 ½
Attanasio (Athanas)	Savo		1 ½	

Ito	Senelli	1 ½
Stepo	Nellio	1 ½
Ghioni (Gjoni)	Zacco (Zaho)	1 ½
Attanasio	Dimo (Dhimo)	1 ½
Resul	Memo	1 ½

***Klasa e tretë***

**Dukati**

Braim (Ibrahim)	Cassani (Hasani)	1
Polio	Ilia	1
Matteo	Sinani	1
Attanasio (Athanas)	Machometi (Muhameti)	1
Nicca (Nika)	Dava	1
Giovanni (Xhiovan)	Gabili	1

Shpërblime, që duhet t'u jepen fshatrave në brendësi të Provincës së Himarës, për komunikimin me Albaninë për mbrojtjen e te rekrutuarve dhe për të lehtësuar rekrutimin:

Borsi - Borshi 20 monedha ari

Drubaci - Terbaçi 5 “

Vranista - Vranishti 4 “

Kalaratos - Kallarati 3 “

**PERMBLEHDJE**

Shpërblime për paritë e fshatrave, përveç Kuçit dhe Dukatit, do t'u jipen edhe prindërve të kadetëve, që u përmendën më sipër, ashtu si do të shpërbehne dhe paritë e këtyre vendeve:

Shpërblime, pensione jetese dhe shpenzime udhëtimi për fshatart e përmendura: 40 monedha ari

Shpërblime pensione jetese dhe shpenzime udhëtimi Kuçi dhe Dukati 141 “

Shpërblime për ipeshkëvinë dhe priftërinjtë: 10 “

Shpërblime për fshatrat Borsh, Tërbaç, Vranishta dhe Kallarati 32 “

Ky dokument është i shoqëruar me një shënim të gjatë, për mënyrat dhe kriteret e pagesës të shpërblimit.

E gjithë kjo procedurë është miratuar me respektin e duhur, është ndjekur me durim të madh dhe firmosur

në Himarë më 29 qershor 1794

Giovanni Spiro e Costantino Casnezi

Xhiovan Spiro dhe Kostantin Kasneci

Ky dokument është i shoqëruar me një korespondencë të gjatë letrash të shkruara në Albania nga togeri D. Xhovan Spiro dhe D. Kostantin Kasneci, dërguar mareshallit Naselli me 3 shtator 1791.

Korespondenca u vazhdua më tej, me letra të shkruara nga toger Xhovan Spiro, i Regjimentit Maqedonia i

Mbretërisë së Napolit, dërguar mareshallit Naselli. (16)